



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i kuvendit-

01Nr.060/01-23166/20
Kaçanik, 25.09.2020

PROCESVERBAL

Dëgjimi Publik me Administratorët e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, i organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe Financa, lidhur me Propozim Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023. Dëgjimi publik është mbajtur me datë 25 Shtator 2020 (e Premte) në sallën e Kuvendit të Komunës.) me fillim pune në ora 11:00.

Në takim ishin të pranishëm : Kryesuesi i Kuvendit dhe i KPF, Kemajl Mërseli, anëtarët tjerë të KPF-së: Nexhat Loku, Pranvera Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka.

Në mbledhje mori pjesë anëtari i KK nga NISMA, Bekim Koxha.

Nga Ekzekutivi i Komunës në Dëgjim publik morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Ylber Bajra, Drejtorët e Drejtorive Komunale: Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Fatmir Loku, Bahri Selimi dhe Diana Reka.

Në Dëgjim publik morën pjesë: Administratorët e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane (bashkangjitur keni edhe listën e pjesëmarrësve në takim).

Dëgjimin publik e kryesor, Kemal Mërseli, Kryesuesi i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare për punë të KK.

Tema: Propozim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2022-2020.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Kemajl Mërseli, Ju përshëndes dhe ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë dëgjim publik të organizuar nga Kuvendi i Komunës përmes KPF, lidhur me Propozim Buxhetin e komunës për vitet 2021-2023. Siç e parashohin rregullat ligjore, buxheti duhet të dërgohet në Kuvendin e Komunës me 01 Shtator, pastaj KK përmes Komitetit për Politikë dhe Financa, për organizimin e dëgjimit publik për marrjen e kërkesave të qytetarëve, e pastaj buxheti shkon në procedurë të KK për aprovim deri me datë 30 shtator. Në këtë rast pasi jemi në kohë pandemie, në pamundësi me organizuar dëgjime të mirëfillta publike me qytetarët për me u dëgjuar zëri i secilit qytetar, ne kemi bërë kërkesë dhe njoftime që qytetarët me i adresuar kërkesat e tyre të përfaqësuesit e tyre që ata me i ngritur në dëgjime publike, duke respektuar rregullat nga IKSHPK.

Propozim Buxheti na është dërguar diku me 14 Shtator, dokument është bërë publik menjëherë në Faqen zyrtare të komunës dhe në facebook të komunës. Të gjithë qytetarët kanë pasur mundësi me shikuar projeksionet për vitet 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023 në mënyrë që kërkesat e tyre t'i adresojnë të përfaqësuesit e tyre që ju t'i ngitni në këtu.

Kryetari dhe drejtori i financave janë prezent këtu në mbledhje, buxheti i komunës është 8,782,599.00€, i cili buxhet është shpërndarë në 5 shtylla kryesore. Pjesa më e madhe e mjeteve shkojnë për paga dhe mëdijtje, mallrat dhe shërbimet, shërbimet komunale, investimet kapitale, subvencione dhe transfere. Çështja që prekë më tepër interesat e qytetarëve janë shpenzimet kapitale.

Fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi,

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Faleminderit Kryesues, Përsëndetje për të gjithë. Mirë se keni ardhur, po me vjen mirë që për herë të parë sot po e shoh sallën e mbushur, se kemi pasur gjithmonë vullnet me i parë qytetarët për me diskutuar për shqetësimet që i kanë dhe mundësitë tona çka mundemi me bërë. Sot po e shoh sallën e mbushur për herë të parë dhe nga kjo prezencë kemi me qenë edhe më të kujdesshëm më i dëgjuar shqetësimet e juaja dhe mundësitë me e orientuar buxhetin në mundësitë çfarë i kemi. E tha edhe kryesuesi i kuvendit që buxheti i komunës është, 8,782,599.00€, ndërkaq shqetësimet që ngritën nga qytetarët e komunës janë pikërisht për investime kapitale. Siç e keni parë, ne si ekzekutiv i komunës e bëjmë një orientim në bazë të kërkesave të qytetarëve dhe mundësive tona për një orientim të projeksioneve të buxhetit për vitin e ardhshëm dhe vlerësimet për vitet 2022-2023. Nga takimet me qytetarët, i vlerësojmë projektet më të rëndësishme, shpresoj edhe sot nëse një projekt shihet së nuk është me prioritet sesa projekti tjetër, do të hasim në mirëkuptim. Ne kemi pasur një debat më herët për çështje të buxhetit, mirëpo në situata që jermi është obligim siç e tha kryesuesi i KK që para mbledhjes së KK e cila është në fund të muajit të mbajmë një dëgjim publik, në mënyrë që t'i kemi projeksionet buxhetore në formë sa më reale. Dua të sqaroj se buxheti në fillim ka qenë edhe për 205 mijë euro më i lartë, mirëpo për shkak të pandemisë qeveria ka vendosur komunave me ua hequr një pjesë të granteve, për komunën tonë, shuma 205 mijë euro, e që i bien mbi 10% të IK. Megjithatë unë kam qenë anëtar i komisionit të granteve me kryetarin e Hanit të Elezit, që nuk e kemi miratuar kërkesën e tyre, megjithatë qeveria ka gjetur një formë të miratimit të buxhetit, kështu që jemi detyruar këto 205 mijë euro më i reduktuar të ik.

Para juve janë të parapara projektet, normal duke marrë parasysh shqetësimet e përfaqësuesve të komuniteteve, megjithatë, do pjesë të vogla të projekte, si të kanalizimit, rrugët, nuk e kemi pa të arsyeshme me futur shumë fshatra, sepse ka rrugë që janë 100 apo 200m që ato i përfshijmë në kodin e projekteve të ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve lokale. Nëse ndokush ka kërkesë për rrugë lokale të vogla, mos të merr si shqetësim, sepse kemi vlerën 250 mijë euro për ku mundohemi me i inkorporuar të gjitha projektet e vogla. Nëse diçka na ka ikur, ndonjë projekt i madh, mund të ngitet këtu, por diçka që nuk mund të ndryshojmë është që shumën e projekteve kapitale nuk mundemi me ndryshuar, me përjashtim mundësisë së thithjes së investimeve nga niveli qendror që po shpresojmë që jemi përfitues i një granti të performancës në shumë 260 mijë euro, e cila shumë na ka bërë komod që mos me ndier mungesën e mjeteve të Investimeve Kapitale (IK), të zvogëluar nga qeveria. Pjesën e projekteve madhore të IK e kemi orientuar në nivel qendror. Unë po i jap në pika të shkurtra kërkesat të cilat i kemi orientuar në ministrinë e linjës, shpresojmë diçka nga këto do të tërheqim. Kërkesat e dërguar ministrive janë:

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS

Ndërtimi rrugëve në zonën urbane të qytetit, vlera e parallogaritur=250,000.00€

Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës që lidhë vendbanimet: Gërlicë-Kaçanik Vjetër-Stagovë -Runjevë, vlera e paralogaritur e projektit: 3,211,037.24€

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës alternative në fshatin Biqec, vlera e paralogaritur e projektit: 320,259.58€

Zgjerimi i rrugës, ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në rrugën "Ramadan Xhokli"-Koxhaj, vlera e paralogaritur e projektit=197,646.05€,

Rehabilitimi i segmentit rrugor "Komandant Bardhi"-K.Vjeter -Begracë, vlera e paralogaritur e projektit =298,356.06€

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Ismajl Raka" segmenti Shtëpia e Kulturës-Xhamia e Dëshmorëve, vlera e paralogaritur e projektit=125,842.00€

Asfaltimi i rrugës "Hamez Jashari"dhe Martiret e Lirise"-fshati Koxhaj, vlera e paralogaritur e projektit: 272,100.27€

Asfaltim i rrugës Kotlinë-Ivajë, vlera e paralogaritur e projektit 60,000.00€

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS

Ndërtimi i rrugës që lidh pjesën jugore të Kaçanikut me rrugën nacionale N2, mjetet e ndara për këtë projekt në vitin 2020 kanë qenë 100,000.00€.

Ndërtimi i rrugës Viti-Kërbliq-Kaçanik, mjetet e ndara nga Ministria e Infrastrukturës për këtë projekt në vitin 2020 kanë qenë 50,000.00€.

MINISTRISË SË ARSIMIT

Ndërtimi i SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik- 937nxënës (Kërkesa dhe formulari i aplikimit me dokumentacionin përcjellës janë në MASHT, vlera e përafërt 1,300,000.00 euro).

Ndërtimi i aneksit të gjimnazit "Skenderbeu"- 728 nxënës (Kërkesa dhe formulari i aplikimit me dokumentacionin përcjellës janë në MASHT, vlera e përafërt 700,000.00 euro)

Ndërtimi i sallës së edukates fizike në SHFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj-323 nxënës (Kërkesa në MASHT, vlera e përafërt 200,000.00euro)

Ndërtimi i sallës së edukates fizike në SHFMU "7 Shtatori" në Begracë-304 nxënës (Kërkesa në MASHT, vlera e përafërt 200,000.00euro)

Ndërtimi i sallës së edukates fizike në SHFMU "Idriz Seferi" në Bob-265 nxënës (Kërkesa në MASHT, vlera e përafërt 200,000.00euro)

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE AMBIENTIT

Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Begracë=304,299.44€

Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit Lepenc dhe Nerodime, 1,304,289.00€

Ndërtimi i rrjetit të ujësjellesit në fshatin Ivajë, vlera e paralogaritur e projektit=197,646.05€,

Ndërtimi i kolektorit kryesor të rrjetit të kanalizimit Gërllicë-Guri Shpumë, vlera e parallogaritur e projektit=1,025,289.00€

Ndërtimi i kanalizimit fekal në zonën turistike -Strazhë-faza II-të, vlera e parallogaritur 153,860.00€

Studimi i fizibilitetit në zonën turistike "Liqeni i Ivajës"-fshati Ivajë komuna Kaçanik

MINISTRIA SË PUSHTETIT LOKAL

Ndërtim i aneksit të objektit të Administratës Komunale-Kaçanik, vlera e parallogaritur e projektit= 298,000.00€,

Ndërtimi i parkingut nëntokësor pranë objektit të Administratës Komunale-Kaçanik vlera e parallogaritur e projektit= 488,000.00€

MINISTRISË SË PUNËS DHE MIRËQENJES SOCIALE

Ndërtimi i objektit për banim Social, vlera e projektit 358,417.58€

Kryesuesi i Kuvendit- Kemal Mërseli, I dëgjua sqarimet e Kryetarit të Komunës në planifikimin buxhetor 2021-2023, fjala është e juaja. E Hapi debatin:

Nexhmedin Lika- Administratori i f. Strazhë, Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë. Buxheti i komunës është i mirë i hartuar, mirëpo ka qalim të shpërndarja e tij të projeksionet për f. Strazhë. Ne f. Strazhë kemi adresuar disa kërkesa në komunë, si për ujësjellës në f. Strazhë, ndërkaq në këtë projekt buxhetor nuk e pash së është përfshirë ky projekt. Edhe të Zona e mbrojtur në f. Strazhë, duhet komuna me bërë diçka me u mbajtur ai park, më investuar diçka në atë park, ndonjë karrige apo diçka tjetër.

z. Fadil Vishi- Administrator i f. Dubravë, Përshëndetje për të gjithë, Unë i kam lexuar projeksionet e buxhetit, ndërkaq nuk pashë së në këtë projeksione f. Dubravë, edhe pse ky fshat nuk ka kërkesa të mëdha, por besoj se janë përfshirë në projektet të cilat i potencoj kryetari. Ndër prioritetet për f. Dubravë, është: Shtimi i kapacitetit të ujit të pijes, sepse kemi shumë problem me ujin e pijes. Drejtori Ramadush Osmani veç e dinë së ne jemi furnizuar me ujin e Rekës.

2, Vazhdimi i trotuarit që ka mbetur në gjysmë, nga Ura e Lepencit me lidhë me varrezat e dëshmorëve. Nuk është gjatësi e madhe, ndërkaq me lidhë në këtë pjesë edhe ndriçimin publik.

Për drejtorin e DSHPE, Çështja e ndriçimit publik që është në Dubravë, dritat ndezën 9 apo 10, ndërsa ç kyçen në ora 1 të natës, ndërkaq njerëzit po udhëtojnë në terrë pas këtyre orëve. A ka mundësi me u ndryshuar orari i ndriçimit publik në atë pjesë.

3. Kam një Kërkesë për Kryetarin e KK, lidhur me një taksë komunale e cila taksë dallon shumë nga ajo e Ferizajt. Në një regjistrim të mëvonshëm për dy prindërit e mijë që kanë vdekur, unë kam paguar dënim për regjistrim të mëvonshëm 80 €, ndërkaq për prindin tjetër që është dashur me çregjistruar në Ferizaj kam paguar 50€. Kjo me duket e paarsyeshme, me qenë me të fortë ne si komunë sesa Komuna e Ferizajt. A ka pasur mundësi ky dënim me qenë më i ulët. Ë kam dokumentin për argumentim.

Kryesuesi i Kuvendit - Kemal Mërseli, Komuna e ka të miratuar Rregulloren për taksa, ndërkaq propozimi vjen nga Ekzekutivi i Komunës, nga DAP. Sa e di unë Rregullorja e taksave është unike për krejt Kosovën, se na ka ardhur e gatshme. Ne kemi qenë komuna e parë që e kemi miratuar rregulloren, drafti ka qenë edhe në debatin publik me qytetarë.

Ka mundësi që Ferizaj është duke punuar me rregulloren e vjetër, ndërkaq deri në fund të vitit e kanë obligim me miratuar rregulloren e re, Edhe nëse është ashtu, draft rregullorja vjen nga ekzekutivi me parametra e shumave që sigurisht i marrin në qeveri, pastaj zhvillohen procedurat tjera.

z. Fadil Vishi- Administrator i f. Dubravë, Nuk është puna për mua se unë i kam kryer ato, por puna është së kjo është ngarkesë për qytetarin e komunës. Deri vonë në Kaçanik kishte qenë 10 € kjo taksë, ndërkaq tani është 80 €, e që kujtoj së është shumë. Ne Ferizaj kishte qenë 20€, me herët tarifa, ndërkaq ata me thanë se kemi pasur propozim nga 50-100 €, ndërkaq e kanë miratuar minimalen. Ferizaj ishte duke punuar me rregullore të re të taksave.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Për mua është e padrejtë për shkak të mërgimtarëve të cilët nuk mundën me ardhur me bërë çregjistrimin e të vdekurit në afatin e përcaktuar, ndërkaq juve nuk iu falet, së 30 ditë i keni në dispozicion dhe mos me pasur mundësi me kryer një obligim. Neve ndoshta kemi bërë gabim të çështja e tarifës për mërgimtarët që vdesin atje dhe e varrosin atje, dhe nuk mundën me ardhur me kohë me bërë çregjistrimin, këtë nuk e kemi menduar, ndërkaq për ne këtu nuk ka arsye për vonesa të çregjistrimit. Unë po flas në përgjithësi në kushte normale çështjen e çregjistrimit, ndërkaq dhe mund të ketë ndonjë rast specifik.

Të çështjet që i ngriti Nexhmedini, Ju e dinë që çështja e ujësjellësit në Strazhë, ato para sivjet dhe vjet kanë ndenjur, për shkak së ju e keni marrë për sipër dhe keni marrë obligimet e juaja dhe unë jam zotuar që kur t'i kryeni ju obligimet e juaja, ua qes mjetet. Ketë e kam thënë publikisht dhe sot po e themi. Në momentin kur ju e bënë marrëveshjen, na tregoni dhe mjetet janë në dispozicion. Ne e kemi tani një fond që po e ndajmë për turizëm. Sivjet na ka ardhur si ide, po shpresojmë vitin e arshëm, se sivjet është bërë vonë, ndërkaq nuk e di a mund të bëjmë edhe stazën e biçikletave, për shkak se ka me pasur lëvizje

Të livadhet e Strazhës jemi duke bërë përpjekje bashkë me kryesuesi në KK me rritur pak atë zonë, sepse ka të interesuar, deri tani janë tre kompani të interesuara që donë me investuar miliona euro në atë zonë. Po shpresojmë së është një nismë e mirë, deri me tani ka pasur të interesuar, kemi pasur 2-3 raste nga Turqia, por nuk ka qenë mirë e rregulluar me letra ajo zonë, që së paku ai që e merr e rregullon dhe e mirëmban. Ne e dimë sesa vizitorë janë vetëm ditëve të vikendit.

Për parqe të vogla, niseni iniciativën se ka shumë që e kanë nisur dhe i kemi ndihmuar, këto iniciativa me kanë pëlqyer së është bërë me aktiv komuniteti.

Të çështjet që i ngriti Fadili, ju e dini rastin e ujësjellësit në Dubravë, ka qenë iniciativë e komunitetit. Komuna e ka përkrahë, ndërkaq për kapacitetin, ne mund të dalim me ju në terren dhe me shtuar kapacitetin e ujit se tani investimi është më i vogël me i lidh burimet e ujit- nga bazeni me gyp të burimi.

Trotuari me vazhduar, pajohem, ndërkaq të ndriçimi, nuk e di, se jemi pak keq për momentin.

z. Avni Gabrrica-Administrator i f. Koxhaj, F. Koxhaj nuk e pashë të përfshirë në projeksionet buxhetore. Kryetari e sqaroi se nuk ka mjaftë buxhet, ndërkaq në këtë fshat nuk është së ka pasur ndonjë investim. Jemi keq me trotuar, ndërkaq edhe rruga është shumë e ngushtë. Jemi diku 140 shtëpi, ndërkaq shqetësuese është mungesa e ujit të pijes. Edhe pse thuhet se u rregulluar çështja e ujësjellësit, ujë të pijes nuk ka komuniteti ynë.

Kryetari i Komunës -Besim Ilazi, Nuk është bash ashtu si po thoni ju z. Avni, uji është bërë, kanalizimi është bërë në fshatin Koxhaj, por çështja së janë bërë do defekte, A është

të keqpërdorimi i ujit apo bllokimi i ndonjë gypi unë nuk e di. Disa rrugica i kam shtuar në atë fshat, bile fillimisht i kam shtruar do oborre, e vetmja është kjo rrugë dhe për atë ne e kemi ndarë fondin, dhe nëse ministria pak na ndihmon, po shpresoj se do të përmbyllem në vitin e ardhëm, së është e vërtetë se keni shumë nevojë për trotuar, ndërkaq e di së rrugën e keni bërë me vetëfinancim, por nuk mundeni me thënë se nuk është bërë asgjë për f. Koxhaj.

z. Shaban Dubova-Administrator i f. Drenogllavë, Faleminderit për ftesën. Sa i përket planifikimit buxhetor, që 20 vjet nuk na keni investuar asgjë në këtë fshat. 6 km udhëtoj Drenogllavë- Kaçanik 500 € na i keni paraparë për projekte në këtë fshat, çka behet me ato 500€, edhe 5000 nëse janë, nuk mundeni me u përmbyllë tri gropa te përmendorja, dhe aty të uji ne qafë të Drenogllavës nuk i mbulojnë. A keni dal ndonjëherë kryetar me këtë kryesi me na vizituar. Unë i kam 37 krerë lopë, dhe unë nuk dua me lëshuar fshatin.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Fshati e keni lëshuar, familja jote jeton ne Ferizaj, tregoju drejtë këtu. Projekt 500 euro nuk ka, por 5000€ e më tepër.

z. Shaban Dubova-Administrator i f. Drenogllavë, Unë tri katër regjistrime i bëjë në Kaçanik, rryma nuk kemi 16 ditë pa rrymë brenda muajit, 14 me rrymë Në këtë muaj që 7 dite nuk kemi rrymë, 22 ore pa orë në ditë, unë nuk e shoh te arsyeshme, kjo është presion me u largua nga fshati. Çka keni dobi ju që me lëshuar në fshatin, sikurse e lëshuan 40 shtëpi, dhe kane mbetur dy tri shtëpitë cilat edhe duke dashur me investuar- (paguar taksa) në Komunën e Kaçanikut, ju po doni me na përzënë. Çka keni kundër Drenogllavës.

Kryetari i Komunës -Besim Ilazi, Është vërtetë që keni nevojë për asfalt, unë nuk po e kontestoj, po qe thua se asfalti është kusht mos me lëshuar fshatin, këtë harroje. Ne e kemi këtë nga përvoja si rasti i Kotlinës që është shtruar rruga qe 15 vjet, por qytetarët ikin për një jetë me të mirë. Edhe familja jote nuk është aty dhe nuk të vjen në fshat, ti je aty se familja jote jo, Ne kemi bërë kërkesën për ndërtimin e rrugës, Kerbliq-Viti, dhe tani është nënshkruar marrëveshja për ndërtimin e saj.

Kryesuesi i Kuvendit- Kemal Mërseli, Unë kam qenë në Drenogllavës, 6 km rrugë janë në këtë fshat, vullneti ekziston, ndërkaq dihet buxheti i komunës, kështu që duhet dallohet vullneti dhe mundësitë.

z. Shaban Dubova-Administrator i f. Drenogllavë, Ju kemi realizuar projekte ne Kaçanik e vende tjera që nuk janë të nevojshme. Kontribut asnjë nuk ka dhënë me shumë se unë. Hajde ti sot dhe shikoje se si mundeni me arritur deri në fshat nga Kaçaniku. Ky është presion kryetar që po i bëni këtij fshati veç me lëshuar fshatin. A keni qenë ndonjë herë në Drenogllavë me parë gjendjen e rrugës, a i ke lypur taksat me ti paguar qytetarët e atij fshati. Unë i paguaj shtetit 5000 € taksa ne vjet.

Kryetari i Komunës -Besim Ilazi, Për taksat që i paguan qeverisë, je duke marrë nga shteti. Nuk mundesh me debatuar në këtë formë, së mundem me ta ndërpre fjalën.

z. Shaban Dubova-Administrator i f. Drenogllavë, Unë jam i sinqertë dhe dua me jetuar ku me ka lënë prindi. Ai fshat ka pasur 900 krerë dele para lufte, ndërkaq sot nuk janë.

Kryesuesi i Kuvendit -Kemal Mërseli, E para pikë, nuk mundesh me debatuar ne këtë formë, mundesh me marre fjalën me i shpreh shqetësimet e tua, dhe me përfunduar fjalën, ose rri e dëgjo e mos u shpreh ne atë formë për hallet dhe dertet e tua dhe me i penguar të tjerët.

z. Shaban Dubova-Administrator i f. Drenogllavë, Fjalën nuk mundemi më ma ndërpre askush. Unë nuk kam ardhur me i dëgjuar këtu kah shtrohen edhe livadhet e Kaçanikut.

z. Bekim Koxha, Anëtar i KK nga NISMA, E ndej si shqetësim çështjet që i ngiti administratori i f. Drenogllavë, ndërkaq nuk është njerëzore me ia ndërprerë fjalën. Buxhetin edhe ky që është, Shabani i shprehi shqetësimet e tija, kryetari i ka arsytet e veta, pse nuk ka buxhet, po shihet se nuk ka buxhet, me pasur mundësi me bërë një zgjidhje për rrugën e f. Drenogllavë, se paku me zhavorr me shtruar rrugën me i mbuluar ato gropa, që rruga me qenë e kalueshme qe mos me pasur probleme, se asfalt dihet se nuk mund te shtrohet.

Fadil Lika, qytetar, Sot për herë të parë jam në dëgjim publik. Kërkesat i paraqes si qytetar, disa gjera elementare qe janë te vogla komuna i ka kryer dhe i kryen pa problem. Kërkesat e qytetarëve duhet me qene esenciale, të favorshme për lagje apo komunitete. Faleminderit shumë kryetar qe ke arritur që kërkesat e qytetarëve me i bërë realitet për në infrastrukturë; rrugore, ujë, kanalizim. Unë jam sot këtu me shpreh falënderime për kryetarin dhe të gjitha drejtoritë që kanë marrë iniciativë me bërë asfaltimin e rrugës "2 Korriku"- emërtimi i ri, Rruga: "Avdurrahim Shehu". Për herë te parë, unë i kam përcjellë punimet në këtë rrugë dhe jam shumë mirënjohës e krenar që punohet kështu. Zgjerimi i rrugës është fenomenal, shtrirja e rrjetit është fenomenale. Shqetësimi unë është mos te mbetemi pa ujë të pijes. Sa i përket ndarjes të projekteve, duhet me i njohur të gjitha fshatrat dhe qytetin dhe me vlerësuar se cilit nga prioritetet me iu dhënë prioritet. Propozoj me i dhënë prioritet, ndërtimit të Kullës se Hasanit, kur dihet rëndësia e kësaj kulle. Nëse ka mundësi, është mirë, kur dihen vlerat e këtij objekti. Pasi vijë nga f. Strazhë, Lapidari ne Shtrazë, ka nevojë për një intervenim të lehtë, sepse ngricat veç kane filluar me dëmtuar. Nëse ka mundësi dhe mjete, sepse vula është dhënë për këtë projekt nga kryetari me ndërtimin e tyre. Te jemi falënderues si fshat, ndërkaq ky projekt të behet brenda mundësive dhe nëse shihet si prioritet, të behet me pllaka ose mermer. I jam falënderues drejtorëve për mbikëqyrjen e rrugës, "Avdurrahim Shehu".

z. Isni Bela-Administrator i f. Gjurgjedell -lagjia Kashan, Projektin e rrugës e kemi bërë qe 1 vit e gjysmë, lejen e kam marre nga kryetari, kam hyrë borgj dhe është bërë me mjete tona. Ne dy raste komuna na keni ndihmuar nga pak, por, tani rruga është dëmtuar përsëri. Një ditë me herët e bëra një kërkesë, përgjigja është negative, fjalën nga ju e kam marrë kryetar për këtë projekt. Sa i përket fshatit Gjurgjedell nuk kemi pasur qare pa e lëshuar fshatin, sepse vendin e kanë shkatërruar kompanitë private, këtë e dini ju edhe inspektorët. Mbi 60 nxënës janë në Kashan, na ka dal ne ndihmë kryetari i Hanit te Elezit në bartjen e nxënësve për mësim në shkolla të Hanit të Elezit. Çështja e kanalizimit qe është në fshat, jemi ne hall me çka mundet me u bërë infektimi i nxënësve. Ju lutem ne emër të fëmijëve na bëni një zgjidhje kryetar, nënkryetar, drejtorë, se nuk kam ku shkoj unë si administrator i këtij fshati.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Ju si kryetar i fsh. Gjurgjedell, kur e keni bërë kërkesën për shtruarjen e rrugës, ua kemi shtruar rrugën, asfalti është shtruar ndërkaq ju e

keni lëshuar fshatin, ndërkaq tani keni arsye tjera. Ju po ikni për një jetë me të mirë e jo për rrugën.

2. I keni ndërtuar shtëpitë në Kashan në tokë të huaj, dhe unë nuk di qysh me ua legalizuar. Këtë e dini edhe ju se jeni 40 apo 50 familje që keni ndërtuar në tokë të huaj, këtë e kemi për ju prioritet si me ua zgjidhur. Krejt problemi është të kontesti që i keni uzurpuar pronat pa e pyetur askënd.

z. Isni Bela-Administrator i f. Gjurgjedell, lagjja Kashan, Nuk kemi pasur si me jetuar në Gjurgjedell, ndërkaq rruga është shtruar pasi u trazuam.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Zgjidhja duhet me qenë ligjore për çështjen e ndërtimeve të shtëpive në Kashan. Nëse është çështja e fëmijëve për me i transportuar, në kemi me marre këtë problem shumë seriozisht, ka qenë kërkesë e Nexhat Lokut në Kuvendin e Komunës, pse me shkuar fëmijët e Kashanit në shkollë në Han të Elezit, ky është fajti ynë, këtë duhet pranuar. Çështja e pronave, shtëpive duhet me u rregulluar në formë ligjore, se në na mbaruam me dënime. Nëse në sot e shtrojmë atë rrugë, nesër na qitni në gjyq, për këtë arsye, duhet të rregullohet çështja e pronave, pastaj çështja tjetër është e vogël, se nuk është vlerë e madhe dhe jo e perealizueshme. E perealizueshme është, çështja pronësore. Çështja e fëmijëve, edhe kryetari e ka marrë seriozisht përmes kërkesës time dhe të Nexhatit, dhe ka me u rregullua e me mësuar në shkollat e Kaçanikut ata nxënës, se janë banorë të Kaçanikut, e jo me shkuar në Han të Elezit. Po thoni se iu ka dalë në ndihmë Hani i Elezit, me i transportuar nxënësit e Kashanit, i transportojmë edhe ne.

z. Isni Bela, Administrator i f. Gjurgjedell- lagja Kashan, Hani i Elezit na ja dal në ndihmë së jemi miqësi.

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Transportin e nxënësve deri vjet e kemi bërë edhe ne, kështu që ajo nuk ka qenë arsye, ju nuk keni dëgjuar me i pru nxënësit në shkollat tona. Kjo nuk me pëlqej që po thoni se na ka dal në ndihmë kryetari i Hanit të Elezit, së këtë ndihme a kemi ofruar edhe ne.

z. Jashar Selimi -Administrator i f. Kacanik i Vjetër, Paraqiti shqetësim mungesën e ujit të pijes në disa pjesë të këtij fshati, Çështjen e energjisë elektrike, shtyllat janë të drurit dhe paraqesin rrezik për qytetaret të komunitetit. Kërkesa kryesore e Kaçanikut të Vjetër është, aprovimi i kërkesës për Hartimin e planin urbanistik të fshatit. Kisha kërkuar që sa me parë të aprovohet kjo kërkesë dhe të filloj hartimi i planit, kur dihet se jemi komuniteti i dytë me i banuari.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Lidhur me kërkesat e z. Jashar Selimi, Të uji i pijes, është e vërtetë, kemi telashe, por juve si administrator dhe Begracen iu kanë pas akuzuar se keni qitur ujë edhe jashtë, në Sedovine dhe Provoli. Më shumë na ka dëmtuar Begraca që gjysma e ujit i ka shkuar në Sedovinë. Duhet me bërë përpjekje me gjetur një formë me shtuar kapacitetin e ujit të pijes. Të shtyllat, ka mungesë të rrymës, por unë nuk jam kompetent me shtuar kapacitetin e rrymës. Të plani urbanistik, po pajtohem plotësisht me kërkesën tuaj. Me vjen mirë që me kritikove, së krejt me akuzojnë se investimet kanë shkuar veç në Kaçanik të Vjetër.

z. Selim Reka-Anëtar i KK nga LDK, Unë jam anëtar i KPF nga LDK, ky takim ka qenë i paraparë me u mbajt 2 ditë me herët, mirëpo është shtyrë për dy ditë për shkak të

një takimi të kryetarit dhe kryesuesit. Mirëpo ne e kemi mbledhjen e KK dhe do t'i marrim parash kërkesat e juaja. Shqetësimi im në mbledhjen e KPF ka qenë një kërkesë e kamotshme, këtë shqetësim e kam shprehur edhe te kryetari komunës, me çka mundemi edhe me iu falënderuar kryetarit se ka bërë përpjekje, mirëpo problemi nuk është zgjidhur ende. Derisa nuk është zgjidhur problemi, presioni ynë ka me qenë i vazhdueshëm, se me prioritet sesa uji i pijes nuk ka. Një pjesë e madhe e qytetit nuk ka ujë të pijes.. Kemi kërkuar të shtohet mjetet për ujësjellës dhe nga viti i kaluar është shtuar fondi për ujësjellës, mirëpo problemi është të projekti. Unë kam kërkuar nga mjetet që janë ndare për ujësjellës, të hartohet projekti i ujësjellësit. Kryetari ka marre një iniciativë që do të angazhohet rreth kësaj çështje, e ka thirrë kompaninë e Ferizajt për me bërë projektin se ata janë eksperte të fushës, dhe ka mundësi me u bërë projekti, se njësia e Kaçanikut nuk ka ekspertë të fushës dhe jemi të pajtimit me pasur një takim me ata të kompanisë dhe shpresojmë që do t' realizohet.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, E di se e jeni ngritur këtë çështje, ndërkaq po të jap një zotim që nëse kompania do të bëjnë projektin se janë të thirrur me bërë projektin, po të garantoj se kam me dyfishuar këtë fond me të hyrat vetanake. Po me dhimben me dhënë para për projekt, se kompania janë te thirrur për projektin, është mirë edhe ju me bërë presion nga ana e juaj kushdo që ka ndikim në këtë çështje.

z. Kijani Sallahu- Administrator i f. Biçec, Faleminderit shumë kryetar, përshëndetje për të gjithë, me zbuti revoltën Jashari kur kërkoj me bërë investimet në Kacanik të Vjetër, si fshati i dytë më i banuari. Pas Begracës e Kacaniku të Vjetër, Biçeci, është fshat i madh, ndërkaq nga projeksionet buxhetore shihet së Biçecin e keni lënë me poshtë se disa lagje të f. Doganaj. Vërejtjet e mija janë, të shpërndarja e buxhetit, buxheti nuk është ndarë në formë racionale kryetar. Në f. Biçec, Palestra sportive të shkolla e fshatit është përmendur ndër tri palestrat e para sportive që ka me u ndërtuar, këtu në projeksionet buxhetore është përfshirë në prioritet, ndërkaq kryetari nuk e përmendi. Me vet faktin që nuk e përmendi kryetari palestrën, po duket se është ç'vendour ky prioritet. Asnjë projekt me kod te veçantë në f. Biçec nuk është paraparë me këtë planifikim buxhetor. Mbetet me shpresuar të rehabilitimi i rrugëve, ndriçimi publik, kanalizim, ujësjellës, nëse diçka mund të këtë për f. Biçec. Dihet se në të gjitha këto fusha projektet ekzistojnë dhe i kemi dorëzuar, shpresojmë që të merren parasysh dhe të këtë investime edhe të ne në f. Biçec. Tjetër, të menaxhimi i projekteve, kërkoj që komunikimi me qenë i rregullt me administratorin e jo me tjetër qytetarë tjerë të komunitetit.

Kryetari i Komunës -Besim Ilazi, Çështja që thuhet së nuk është investuar në f. Biçec, kjo nuk qëndron. Në vitin e kaluar e kemi bërë një rrugë të re alternative me asfalt dhe rrugën e dytë alternative e kemi bere me zhavorr midis fshatit dhe e treta rrugë është e asfaltuar. Kanalizimi në pjesën dërmuese është rregulluar, ndërkaq ndriçimi publik nuk është bërë, pjesët tjera janë projekte të vogla në kuadër të një kodi buxhetor. Duhet me thënë secili ky projekt kryetar nuk është prioritet e me hequr, ndërkaq me propozuar me shtuar projektin që mendoni së është me më prioritet.

z. Bekim Koxha- Anëtar i KK nga NISMA, Kërkoj që, Ndërtimi i rrugës, nga Kaçaniku i Vjetër deri të Rakaj me futur si kod i veçantë në projeksionet buxhetore të këtij planifikimi buxhetor.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Aty ku keni ndikim na ndihmoni, që ti kemi lenë kodet, projekti mbetet e unë ndërrohem. Unë jam në gjendje me ardhur me ju, se

investimi jetë e unë ndërrohem., kjo është me rëndësi, si rruga e Kerbliqit, ka hyrë si kod, e tani është nënshkruar marrëveshja.

z. Hasip Salihu- Administrator i f. Bajnicë, Faleminderit, Përshëndetje të gjithëve, Unë i kam dy shqetësime për f. Bajnicë: 1. Çështjen e ujit të pijes dhe 2. Çështjen e kanalizimit. Të projekti i ujit të pijes, edhe pse kemi investuar shumë në këtë projekt, mungesa e ujit të pijes së këtij fshati është e madhe. Të çështja e kanalizimit, kanalizimi është rregulluar në këtë fshat, por çështja është se na ka dalë problem me kanalizimet e f. Semajë, për shkak se nuk është bërë një pjesë e lidhjes së gypave të segmentit të kanalizimit të këtij fshati me segmentin e kanalizimit të f. Bajnicë, kështu që derdhjet e kanalizimit të Semajës janë në lumin e f. Bajnicë, dhe kundërmon erë e rëndë. Kërkoj me shqyrtuar mundësitë që këto dy kërkesa të komunitetin tonë me iu bërë një zgjidhje me buxhetin e projektuar të komunës 2021 dhe vlerësimet 2022-2023.

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Çështjen e ujit të pijes f. Bajnicë është keq dhe e di se e keni në prioritet. Të kanalizimi, ne po bëjmë kërkesa dhe po i dërgojmë edhe ne nivel qendror, është fat i mirë edhe ministria në do projekte na kanë ndihmuar me mjete buxhetore, si ne një projektin e kanalizimit në f. Strazhë. Përsëri do t'ju bëjmë përpjekje sidomos për pjesën e kanalizimit ku është në rrezik fshati, besoj se do të bëjmë zgjidhje. Në vazhdim Kryetari, Besim Ilazi kërkoj që për projekte të vogla, si rrugë të vogla lokale, kanalizim etj. mos e ngitni si shqetësim, ndërkaq për kërkesa të tilla i ftoj në zyrën time me biseduar, se e kemi kodin e veçantë dhe do të mundohemi të bëjmë zgjidhje. Ne jemi duke u zgjeruar me ndriçim publik nëpër fshatra.

z. Bekim Koxha- Anëtar i KK nga NISMA, Shqetësimi me i madh, është uji i pijes, është mirë me marrë një iniciativë që fshatrat, vendbanimet etj. që munden me u lidhë me ujin e lumit, sepse uji po derdhet në Vardar e ne nuk po kemi ujë. Me pasur mundësi me bërë një projekt madhor me ministrinë, që me bërë një zgjidhje të përhershme të ujit të pijes, sepse gypa të ujësjellësit ka mjaftë të shtrirë nëpër tokë, mirëpo, ujë të pijes nuk ka.

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Shqetësimi është shumë me vend, iniciativa kemi nisur, po nuk na janë marrë parasysh dhe na janë thënë se nuk mundemi me i mirëmbajtur, mundësi ka, burime të mjaftueshme ka, po shpresojmë edhe kjo me u rregulluar. Ka pasur iniciativa që na kanë refuzuar fshatrat. CDI ka dashur me investuar në rrjetin e ujësjellësit dhe orë të ujit në Bicec, por komuniteti ka refuzuar. Ajo që pres nga ju është, të më thoni; kryetar ky projekt nuk është me prioritet, hiqe, ne e heqim dhe e fusim prioritetin tjetër që ju mendoni se është me prioritet.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Diskutime të tjera nuk ka, pas këtij Dëgjimi publik me Administratorët e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane e shpalli të mbyllur në ora 12:21. Faleminderit për pjesëmarrje.

Dëgjimin Publik me OJQ, Përfaqësues të Shkollave dhe Grupet tjera të interesit, me temën: Propozim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2022-2020, do të mbahet sot (25 Shtator 2020) nga ora 13:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
Makfire Malsiu



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik

25.09.2020

Tema: Propozim Buxheti I Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023 ,I organizuar nga Kryesiuesi I Kuvendit në konsultim me Komitetin për Politikë dhe Financa, me administratorët e fshatrave.

Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nr.i Telefonit	Nënshkrimi
1. Selim Reka	asambleist	044172937	
2. HASIP SAIHU	ADM.	044-243-039	
3. RAHMAN SPAHU	ADM.	044-228-227	
4. BEKIM HOXHA		044 705 288	
5. BEKIM KOXHA	ASAMBLEIST		
6. EKREM KYÇUQ	asambleist	045-366-175	
7. FATION SHEHU		044142286	
8. AVNI GABRIÇ	KOXHËS	044 854 821	
9. NEVH MEDIN	LIXHA	04 516 720	
10. HAZBI LIKA		044 976 166	
11. ZIBER LUMA		044 930 758	
12. KEMAIL JOKO		044 171-808	
13. JASHAR SELIMI		044-164 799	
14. SHABAN DUKOV		049 827 926	
15. ISNI BECA		044-767-367	
16. KJANI SALLAHU		044 164 710	
17. FADIL VISHI (ADMINISTRATOR)		044 - 225-089	

- 18. PRANVERE ZHARKU ASAMBLEISTE 045-465778 *Fadur*
- 19. Bardh Zenuni Administrator i f.sh. Duraj 044 756 229 *Balla Juri*
- 20. Asfrit - Asaj Administrator f.sh. Gabrice 043-917-273 *REUT*
- 21. BESNIK DEMA ADM. i FSH, ORB - 044- 868 - 303 *Bde parr*
- 22. FADIL LIKA Gjyketar - 044- 325- 964 *A*
- 23. Shefket Berisha *Shefket*
- 24. KADRI DARRISHA *Kadi*
- 25. NOKR MURSHI Administrator Deparj- 044-222-905 *Paraj*
- 26. LUMBARDH MALSIV AD - REKË 043-119-778 *Wit*
- 27. Bejtulla Dalloshi Soponice' *mur*
- 28.
- 29.
- 30.
- 31.
- 32.
- 33.
- 34.
- 35.
- 36.
- 37.
- 38.
- 39.
- 40.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Data	18.09.20	Vendi	Kaçanik
Id. org.	Numri	Shtojcë	
01-060/01-231	66/20		

Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

FTESË PËR DËGJIM PUBLIK

Të nderuar qytetarë të Komunës së Kaçanikut,

Në bashkëpunim me Komitetin për Politikë dhe Financa, në pajtim me rregullat ligjore, kam organizuar Dëgjim Publik me, Administratorë (përfaqësues të zgjedhur) të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, OJQ, Përfaqësues të shkollave dhe Grupet tjera të interesit, për datën **25 Shtator 2020 (Dita e Premte)**.

Tema: Propozim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet: 2022-2023.

Dëgjimi Publik do të mbahet në dy intervale kohore;

Në Ora 11:00, Me administratorët (përfaqësues të zgjedhur) të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Në Ora 13:00, Me OJQ, Përfaqësues të shkollave dhe Grupet tjera të interesit.

Vendi: Salla e Kuvendit.

Në Dëgjim publik, të pranishëm do të jenë: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive Komunale.

Propozim Buxheti është i publikuar në Faqen Zyrtare të Komunës nga data 17 Shtator 2020 në Adresën: <http://kk.rks-gov.net/kacanik/> dhe Facebook të Komunës. Qytetarët e komunës, OJQ dhe Grupet tjera të interesit, kërkesat e tyre i adresojnë të përfaqësuesit e tyre.

Për shkak të pandemisë, virusit Covid-19, Dëgjimi Publik do të mbahet duke respektuar rregullat dhe masat nga IKSHPK.

Qytetarë të nderuar, Bëhuni pjesë e Dëgjimit publik, përmes përfaqësuesve Tuaj, që të jeni pjesë e planifikimin buxhetor 2021 dhe vlerësimeve për vitet: 2022-2023.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

REGJISTËR I ANËTARËVE TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA, nga
Mbledhja Konsultative e KPF, mbajtur me 18 Shtator 2020 ;

Tema: Konsultim për organizimin e një Dëgjimi publik për Propozim Buxhetin e
Komunës Kaçanik për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023, në ora 10:00.

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA				
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Subjekti politik	Pjesëmarrës
1	2	3	4	5
01.	Kemal Mërseli	Kryesues	PDK	prezent
02.	Nexhat Loku	anëtar	PDK	prezent
03.	Pranverë Loku-Zharku	“	PDK	prezent
04.	Ekrem Kyçyku	“	LVV	prezent
05.	Selim Reka		LDK	prezent
06.	Albana Troni	“	Nga AAK/ vepron në KK në Grup të Pavarur	nuk e merrte
07.	Hafize Sallahi	“	NISMA	prezent

Makfire Malsiu

From: Makfire Malsiu
Sent: Thursday, September 17, 2020 11:11 AM
To: Kemajl Murseli; Nexhat Loku; Pranvera Zharku; Ekrem Kyqyku; Hafize Sallahi; Albana Lika; Selim Reka; 'hafizesallahi@hotmail.com'; 'vera_0550@hotmail.com'; 'nexhatloku@hotmail.com'; 'ekrem.kyqyku@gmail.com'; 'hafizesallahi@gmail.com'; 'ana-90-t@hotmail.com'; 'anat@hotmail.com'; 'selimreka2020@gmail.com'
Subject: Ftese per nje takim konsultativ
Attachments: Propozim Buxheti i Komunes.pdf

Përsëndetje të nderuar,

Me Kërkesën e Kryesuesit të Kuvendit, Kemal Mërseli,

Ju ftojme për një Takim Konsultativ të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Takimi do të mbahet nesër me datë 18 Shtator 2020 (Dita e Premte) në ora 10:00, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit

Në këtë takim KPF do të konsultoheni për Organizimin e një, Dëgjimi Publik me qytetarë të Komunës së Kaçanikut, lidhur me;

**1. Propozim Buxhetin e Komunës për vitin 2021 dhe
Vlerësimet për vitet 2022-2023.**

Në Attach e gjeni të bashkangjitur Draftin e Buxhetit....., ndërkaq në mbledhje do të merrni Draftin edhe në kopje fizike.

Draft Buxhetin.....,do të dërgojmë sot për publikim në Faqen Zyrtare të Komunës dhe në Facebook të Komunës.

Respekt!

Makfire Malsiu , MA, Juriste e Diplomuar.

Kontakti:

Tel Mobile: 044 368 302

Email: makfire.malsiu@rks-gov.net